

# Përfundimi i shtatzënisë nga 14 deri në 24 javë: cilat janë mundësitë e mia?

Kjo ndihmë në marrjen e vendimit mund t'ju ndihmojë të zgjidhni ndërmjet opsioneve mjekësore dhe kirurgjikale.

	MJEKËSORE	KIRURGIKALE
Çfarë ndodh?	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ju do të merrni një pilulë të quajtur mifepristone dhe më pas mund të shkoni në shtëpi.</li> <li>Ju do të ktheheni në spital 1 – 2 ditë më vonë për të marrë një tabletë të dytë, që quhet misoprostol. Ky mjekim do t'ju japë kontraktime dhe jepet në doza të përsëritura derisa shtatzënia të kalojë përmes vaginës, e cila mund të zgjasë disa orë në ditë.</li> <li>Ndërmjet 10 dhe 30% e grave* do t'i nënshtrohen më pas një procedure aspirimi.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Një ditë para operacionit, qafa e mitrës përgatitet për ta bërë operacionin më të lehtë. Kjo bëhet duke futur shkopinë në madhësinë e një shkrepseje, të quajtur dilapan, të cilat fryhen me kalimin e kohës dhe/ose merret një tabletë e quajtur mifepristone. Pas kësaj ju do të shkoni në shtëpi.</li> <li>Ditën tjetër, shtatzënia hiqet nëpërmjet mitrës nën sedacion të thellë ose anestezi të përgjithshme dhe zgjat 15-20 minuta.</li> </ul>
Sa kohë do të qëndroj në spital?	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mesatarisht, ju do të qëndroni 2-3 ditë në spital.</li> <li>Nëse keni pasur një prerje cezariene të mëparshme ose një operacion tjetër në mitër, procesi mund të zgjasë më shumë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ju do të jeni në spital për rreth gjysmë dite.</li> <li>Shumica e grave shkojnë në shtëpi në të njëjtën ditë sipas procedurës</li> </ul>
A do ta shoh shtatzëninë?	Ju do të jeni zgjuar dhe e vetëdijshme për procesin. Ju mund t'i shihni produktet e shtatzënisë ndërkohë që ndodhin. Ju mund ta shihni dhe mbani fëmijën, nëse dëshironi.	Ju nuk do t'i shihni produktet e shtatzënisë dhe nuk do të mund ta shihni apo mbani fëmijën më pas.
Dhimbje	Ju do të keni kontraktime të dhimbshme gjatë procesit, por do të keni disa opsione për lehtësimin e dhimbjes.	Ju do të ndjeni dhimbje minimale ose mund të mos ndjeni asnjë dhimbje gjatë operacionit, për shkak të anesteziës. Vendosja e shufrave të dilapanit ndonjëherë shkakton ngërçe të lehta ose gjakderdhje të lehta.
Rreziqet	Të dyja opsionet mbartin rrezikun e gjakderdhjes, infeksionit dhe mbajtjes së indeve të shtatzënisë, gjë që mund të kërkojë një përsëritje të operacionit.	
	<p>Këputje e mitrës (e rrallë) Pamundësia për t'i dhënë fund shtatzënisë (&lt;1/100) Kalimi i shtatzënisë para pranimit Deri në 30% të grave do të kenë nevojë për një procedurë aspirimi vaginale për të hequr çdo ind të mbetur në placentë. Kjo ndodh në sallën e operacionit.</p>	<p>Dëmtim i qafës së mitrës ose mitrës nga instrumentet kirurgjikale (1-4/1000) Pamundësia për t'i dhënë fund shtatzënisë (1/1000) Përfundimi i shtatzënisë para operacionit 3% grave do të kenë nevojë për ndërhyrje kirurgjike të mëtejshme për të përfunduar procedurën</p>
Pas procedurës	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ju mund të keni nevojë për qetësues dhimbjesh për disa ditë</li> <li>Gjakderdhja mund të zgjasë rreth 1 javë (kirurgjikale) ose 2 javë (me mjekim), por duhet të bëhet më e lehtë çdo ditë</li> <li>Mund t'i filloni menjëherë kontraktivët</li> </ul>	

Referencat:

- National Institute for Health and Care Excellence (2019): Abortion Care [NG 140]
- British Pregnancy Advisory Service, www.bpas.org

\*Ne kujdesemi për të gjitha gratë shtatzëna. Megjithatë kjo fletëpalosje u referohet grave, ne e kuptojmë se jo të gjithë personat që u është cajtuar gjinia femër kur kanë lindur do të identifikohen si gra.

## Çfarë ndodh me mbetjet pas përfundimit të shtatzënisë?

Pas përfundimit të shtatzënisë me mjekim ose kirurgji, do të ketë mbetje, të cilat mund të përfshijnë një foshnjë. Ekzistojnë mënyra të ndryshme për të menaxhuar me ndjeshmëri mbetjet, të cilat shpjegohen më poshtë. Nëse nuk jeni e sigurt, ne mund t'i diskutojmë këto me ju në më shumë detaje dhe t'ju japim aq kohë sa ju nevojitet për të marrë në konsideratë atë që është e duhura për ju.

### Do të preferoja që spitali të kujdesej për mbetjet

Spitali do të organizojë kremimin e mbetjeve të shtatzënisë dhe hiri do të shpërndahet në kopshtin e përkujtimit. Nuk është e nevojshme që ju të përfshihen ose të kontaktoheni, përveç nëse e kërkon këtë. Hiri nuk mund t'ju kthehet.

### Unë do të preferoja ta organizoja këtë në mënyrë private

Drejtori i funeralit mund të mbledhë mbetjet nga spitali për një varrim privat, djegje ose varrim. Shpenzimet për këtë nuk mbulohen nga spitali, prandaj kjo duhet të organizohet nga ju ose nëpërmjet një grupi fetar/kulturor.

### Unë do preferoja t'i merrja mbetjet në shtëpi.

Ju mund t'i merrni mbetjet në shtëpi nëse shtatzënia përfundon para javës së 24-të. Mbetjet do të vendosen në një kuti të mbyllur. Është e rëndësishme të mendoni se çfarë do të ndodhë pasi të ktheheni në shtëpi. Nëse keni ndërmend t'i varrosni mbetjet, ju duhet ta keni tokën në pronësi (ose të keni leje nga pronari) dhe mendoni se çfarë do të ndodhë nëse ndërrohet shtëpi. Gjithashtu, është e rëndësishme të merret parasysh nëse ka kafshë shtëpiake ose kafshë në zonë që mund të gërmojnë mbetjet nëse ato nuk janë varrosur mjaft thellë. Nëse preferoni këtë, ne do t'ju ofrojmë informacion shtesë për shëndetin dhe sigurinë.

### Unë do të preferoja më shumë kohë për ta menduar këtë.

Nëse dëshironi të merrni pak kohë për të menduar se çfarë do të ndodhë pas përfundimit të shtatzënisë, thjesht na bëni të ditur. Për të diskutuar më hollësisht mbi opsionet ju mund të na dërgoni e-mail në adresën [whh-tr.bereavementmidwife@nhs.net](mailto:whh-tr.bereavementmidwife@nhs.net), lërnini të dhënat tuaja dhe ne do t'ju telefonojmë kur të jeni gati.

Në rast se keni një koment pozitiv, ankesë ose shqetësim, ju lutemi kontaktoni ekipin e Shërbimit të Këshillimit dhe Kontaktit me Pacientët (PALS) në numrin 020 7288 5551 ose [whh-tr.PALS@nhs.net](mailto:whh-tr.PALS@nhs.net).

Nëse keni nevojë për një kopje me gërma të mëdha shtypi, audio ose kopje të përkthyer të kësaj fletëpalosje, ju lutem dërgoni email në adresën [Whh-tr.patient-information@nhs.net](mailto:Whh-tr.patient-information@nhs.net). Ne do të bëjmë më të mirën e mundshme për të përmbushur nevojat tuaja.